



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 69/12
Prishtinë, më 06.06.2012, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi., Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Xhevdet Neziraj, Albana Fetoshi dhe Muhamet Mustafa.

Mungoi: Naser Osmani.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Ardita Fejza (praktikante), Kushtrim Aliu (praktikant).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Bedri Hamza, Ministër i Financave, Alexander, Beetz Rejhane Zylfijaj (GIZ), monitorues nga KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit dt. 28.05.2012**
3. **Diskutim lidhur me detyrat e komisionit në vështrim të raportit të progresit të komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2011;**
4. **Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi;**
5. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, konstatoi se rendi i ditës miratohet unanimisht.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit me dt. 28.05.2012;

Kryetarja, konstatoi se procesverbali miratohet unanimisht.

3. Diskutimi lidhur me detyrat e Komisionit në vështrim të raportit të progresit të komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2011

Kryetarja, theksoi në pajtim me planin e veprimit të Kuvendit për integritet evropian në vështrim të raportit të progresit, që është bërë edhe pjesë e planit vjetor të komisionit, në tremujorin e parë kemi raportuar me të arriturat, kemi bërë pyetje me shkrim dhe kemi pasur dëgjim me ministrin e Financave. Në tremujorin e dytë kemi disa sfida që duhet adresuar, ndër të cilat kanë të bëjnë edhe me vërejtjet në fushën e prokurimit, me konkretisht në P35 është e përcaktuar që të organizojmë një seancë dëgjimore me KRPP, OSHP, ZAGJ dhe AKK për të diskutuar lidhur me problemet e shkeljes së rregullave të prokurimit. Takimi është planifikuar të organizohet me Komisionin për Mbikqyrjes të Financave Publike dhe do të ftohet edhe Ministria e Financave.

Hykmete Bajrami, ne kemi nevojë të bashkëkordinohemi me komisionin për Mbikqyrje të Financave Publike, sidomos me rastin e shqyrtimit të raporteve financiare, për arsye trajtimi që po i bëjmë raporteve financiare, pa pasur në dispozicion raportet e auditorit është shumë i mangët. Këto gjetje vijnë vetëm nga auditori dhe ne duhet patjetër të mbajmë mbledhje të përbashkëta. Kam një kërkesë që administrata që administrata që mbështet punën e komisionit, të na njoftojë për takimet e KMFP dhe varësisht për cilin institucion jemi përgjegjës, kur të vijnë raportet e auditorit të shkojmë dhe të jemi prezent aty.

Kryetarja, theksoi se natyra e shqyrtimit të raportit në komisionin tonë dallon nga natyra e shqyrtimit në komisionin për Mbikqyrje të Financave Publike. Megjithatë kurdo që të shohim të arsyeshme do të mbajmë një mbledhje me komisionin tjetër. Kërkojë që raportet e auditimit të jenë në dispozicion edhe për anëtarët e komisionit për buxhet dhe financa që në momentin kur vijnë në Kuvend.

Xhevdet Neziraj, vlerësojë se Komisioni i Buxhetit do të ishte shumë më i fuqishëm po të kishim informacionet e auditimit me kohë. Shpesh herë i kalojmë raportet e disa agjencioneve dhe kur po shqyrtohen raportohet në komisionin për mbikqyrje, po gjinden vërejtje. Vlerësoj që do të ishte shumë më e suksesshme që ato komisione që duhet të raportojnë tek komisioni i Buxhetit që së pari të kalojnë tek komisioni për Auditim dhe komisionet tjera pastaj të vije tek komisioni ynë.

Kryetarja, ne në Komisionin tonë e analizojmë rrjedhën e shpenzimeve të institucioneve përkatëse të cilat raportojnë kurse efektshmërinë e shfrytëzimit të mjeteve e ka Komisioni për Mbikqyrjen e Financave Publike në bazë të raporteve të auditorit. Është diskutuar harmonizimi i këtyre dy çështjeve mirëpo institucionet raportojnë në fund të tremujorit kurse auditori bën auditimin në fund të qershorit dhe nuk bën të mbes ana financiare e pa shqyrtuar deri në fund të qershorit kur jepet raporti i auditorit.

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi

Hykmete Bajrami, theksoi se nuk jam shumë e sigurve që kompetencat nga përfaqësuesit civil ndërkombëtar të mund të kalojnë tek Kryeministri. Nuk e kam të qartë pse? Sikur po politizohet çështja e drejtorit të përgjithshëm të thesarit. Nëse ministri emëron është dashur ndoshta të merret pëlqimi nga Kuvendi.

Albana Fetoshi, Ka pasur kuptim ndoshta më parë kur ka qenë tek PCN-ja sepse dihet që kjo ka mbikqyruar Qeverinë, mirëpo tash nëse ia heqim kompetencat PCN-së, atëherë çfarë kuptimi ka që këto kompetenca të kalojnë tek kryeministri dhe mendoj që kompetencat duhet të kalojnë tek Kuvendi. Kam vërejtje tek amendamenti 6, neni 4 ku Qeveria ka sjellur një amendament ku kërkon që në rast të krizave financiare t'i

japin të drejtë Qeverisë të bëj shkurtime ku dëshiron. Është kompetencë e tepërt dhe shumë e panevojshme sepse në rast krizash financiare mblidhen gjithë akterët relevant dhe i diskutojnë çështjet se ku është dashtë të bëhen shkurtime por jo t'i jepet e drejta ekskluzive Qeverisë sepse atëherë çfarë kuptimi do të ketë të quhemi vend parlamentar dhe gjithashtu tejkalon çdo ligj dhe beneficionet që kanë të bëjnë me pagesat financiare edhe nëse janë përvetësuar fondet sipas ligjit të aplikueshëm.

Bedri Hamza, theksoi se Kryeministri ka kompetenca edhe më të mëdha dhe më të fuqishme, në zgjedhjen e udhëheqësve të institucioneve të caktuara. Është post shumë i rëndësishëm prandaj emërohet nga ministri dhe për të mos e lënë vetëm në përgjegjësi të ministrit ka shkuar edhe në instanca tjera. Kjo që thuhet sot me këtë amendament është në harmoni të plotë me nenin 36 i ligjit për Menaxhimin e Financave Publike.

Kryetarja, thesari udhëhiqet nga drejtori i përgjithshëm, ministri është i autorizuar të emëroj drejtorin e përgjithshëm, ndërkaq Kryeministri ka rol vetëm kur është puna shkarkimit të tij, dhe nëse ministri insiston ta shkarkoj drejtorin e thesarit duhet ta marrë një pëlqim nga kryeministri.

Albana Fetoshi, mendoj që çdo gjë që shkruhet këtu është politikë sepse ne me politikë po merremi. Është dashur të bëheni korrekt dhe të thoni nuk është në rregull dhe jo nuk qëndron kjo qfarë thatë, sepse ajo çfarë thash dhe çfarë është shënuar në letër qëndron. Tek kompetencat sa i përket kryeministrit ke të drejtë deri diku kur thua tek çështja e shkarkimit nëse ministri ka ndonjë konflikt interesi me drejtorin e thesarit atëherë ndërhyjnë kryeministri, por pse të mos ia japim këtë të drejtë Kuvendit.

Sali Asllanaj, nuk bëhet ligji për qeverinë Thaqi por për afatgjatë. Do të duhej të konsultohet edhe Kushtetuta lidhur me Kryeministrin. Nenin 4 secila Qeveri ka dëshirë ta ketë kështu, të jetë fleksibile, kur kemi mjete të japim kur skemi të ndalim. Qeveria ka dëshirë të ketë këso lloj nenesh por jo ne. Nuk kam dëshirë t'i japim kaq liri Qeverisë që kur të dëshiron të thotë: ndal se edhe mëditjet po ua ndalim. Qeveria nuk mund të marrë kompetencat dhe të jetë mbi Kuvendin.

Muhamet Mustafa, sa i përket këtij neni rreth thesarit, me te vërtete thesari e ka rangun e ministrave, por tek na e ka aso pozite që vepron në kuadër të Ministrisë së Financave dhe i jep llogari ministrit dhe kjo është pjesë e rregullimit të sistemit financiar dhe duhet të lëmë ashtu.

Më pas filloj procedura e votimit të amendamenteve të propozuara nga grupi punues:

Amendamenti 1, u miratua njëzëri,

Amendamenti 2, u miratua me një votë kundër (Hykmete Bajrami),

Amendamenti 3, u miratua me një abstenim (Hykmete Bajrami),

Amendamenti 4, u miratua me dy abstenime (Hykmete Bajrami dhe Albana Fetoshi),

Amendamenti 5, u miratua me një abstenim (Hykmete Bajrami).

Muhamet Mustafa, lidhur me amendamentin 6, institucionet financiar ndërkombëtare përpiqen të imponojnë diqka që është më e lehtë për tu zgjidhur, mirëpo qeveria nganjëherë duhet me i shfrytëzu edhe mendimet tona edhe me ja bo vetit punën me lehtë jo me marr një përgjithësi kaq te madhe, si është përcaktuar me këtë nen. Një zgjidhje e tillë që përmes vendimit të Kryeministrit të mund të ndërhyhet në buxhet, pa lejen e Kuvendit nuk duhet të ndodh dhe kjo do të ishte kundër sistemit kushtetues që kemi. Çështja e shfrytëzimit të buxhetit në rast krizave duhet rregulluar ndryshe. Nuk mund të anashkalohet e drejta e Kuvendit në miratimin dhe ndryshimin e ligjeve. Qeveria mund të kërkojë prej Kuvendit që në situata të jashtëzakonshme të mblidhet dhe të votojë propozimet urgjente.

Bedri Hamza, çështja që është propozuar me amendamentin 6, është e rregulluar edhe me nenin 36 të Ligjit bazik dhe nuk po shtohet diçka e re, përveç që po sqarohen gjërat.

Albana Fetoshi, theksoi se neni 36 nuk rregullon të njëjtën çështje që është propozuar me këtë amendament. Ai nen rregullon çështjen e transfereve të brendshme buxhetore në rast të paraqitjes së rrethanave të jashtëzakonshme.

Hykmete Bajrami, ligji që u referua e rregullon të drejtën e ministrit për shkurtime buxhetore në rast se krijohen rrethanat, dhe nëse pretendohet se gjithçka është e njëjtë, atëherë pse të shtojmë teksti të ri. Ju lutem na tregoni arsyeshmërinë situatës së jashtëzakonshme, për Qeverinë e Kosovës është për momentin kur hyn në zgjedhje dhe i rrit rogon, i blen votat, ajo quhet situatë e jashtëzakonshme. Prishja e marrëveshjes me FMN është si rezultat i veprimeve të kësaj qeverie. Jam kundër amendamentit 6. Si dhe për qfarë po krijohet fondi për asistencë të likuiditetit si do të shfrytëzohet ai?

Bedri Hamza, fond krijohet për sigurimin e stabilitetit të sektorit financiar në sektorin bankar nuk ka të bëjë me financat e shtetit dhe ky fond krijohet brenda Bankës Qendrore, është pjesë e bilancit të përgjithshëm të buxhetit të Kosovës dhe krijohet nga mjetet të cilat vijnë nga FMN-ja.

Sali Asllanaj, ky nen lenë mundësinë e suspendimit të çfarëdo ligji, në çështjet e beneficioneve fiskale dhe është në themel të kushtetutës. Ajo siq është propozuar ofron kompetencat ekskluzive për ekzekutivin, që ndoshta as në vendet mbretëri nuk i kanë. Nëse thuhet se neni 36 i ligjit bazik ka qenë i mjaftueshëm, atëherë pse të shtohet ky tekst. Duhet të ndryshohet ky reformulim, në të kundërtën nuk e përkrah.

Albana Fetoshi, ky nen dhe neni 36 i ligjit bazik nuk janë të ngjashme, dhe qartë lexohen dallimet në mes tyre. Arsya e FMN-së për ta futur këtë nen, ndoshta ka ardhur nga situata se si po punojmë dhe po shkojmë drejtë krize financiare.

Amendamenti 6 u votua me pesë vota Për (Safete Hadergjoni, Latif Gashi, Jelena Bontic dhe Duda Balje) dhe pesë vota kundër (Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Muhamet Mustafa, Albana Fetoshi dhe Xhevdet Neziraj).

Amendamenti 7, u miratua me një votë kundër (Albana Fetoshi),

Amendamenti 8, u miratuar njëzëri.

5. Të ndryshme.

5.1. Xhevdet Neziraj, njoftoi anëtarët se grupi punues sipas planit të veprimit, ka realizuar vizitat në terren dhe është takuar me përfaqësuesit e institucioneve që janë përgjegjëse në zbatimin e ligjit. Jemi takuar me Njësinë e Intelgjencës Financiare, Doganat e Kosovës, Bankën Qendrore, Prokurorinë e Speciale dhe Administratën Tatimore të Kosovës, nga të gjitha këto institucione kemi parë që ligji ende nuk është duke u zbatuar në mënyrën të rregullt. Ndër arsyt është se ende nuk është shqyrtuar raporti i NJIF në bord që do të shiheshin vërejtjet dhe dobësitë. Në takimet që kemi pasur me drejtorin e NJIF jemi se kërkesa kryesore e këtij institucioni është të ketë kompetencat shtesë të inspektimit në ligjin që do të ndryshohet dhe plotësohet, ndërsa disa institucione si Ministria e Financave nuk pajtohet me këtë qëndrim. Apo kemi raste, si ai në prokurori që thonë se për disa çështje si ajo e konfiskimit të pasurisë ka qenë e rregulluar më mirë me Rregulloren e UNMIK-ut se sa në ligjin ekzistues. Duke parë disa qëndrime të ndryshme të institucioneve të vizituara, nëse anëtarët e komisionit pajtohen, mund të organizojmë një takim të përbashkët

dhe të ftohen të gjitha këto institucione dhe të përballen direkt me qëndrimet e tyre dhe të ofrojnë argumentet për këto qëndrime. Dhe në fund të hartohet raporti dhe të procedohet për shqyrtim në Kuvend.

5.2. Kryetarja, njoftoi për takimin me përfaqësuesit e komisionit evropian që është zhvilluar në Zyrën e saj dhe fokusi interesimi ishte si rrjedh puna në Kuvendit rreth adresimit të sfidave në raportin e progresit. I kam njoftuar për punën që kemi bërë si komision në këtë drejtim, për miratimin e ligjeve që janë kërkuar me raport dhe për rëndësinë e marrëveshjes me FMN-në. Monitorin e ligjit që jemi duke e bërë dhe i kam njoftuar për punën profesionale dhe konsenzuesin e anëtarëve të komisionit në agjendën e integriteteve evropiane.

5.3. Kryetarja, njoftoi edhe për një takim tjetër që kishte me përfaqësuesit nga Hungaria në kuadër të Projektit të binjakëzimit, që financohet nga BE-ja dhe implementohet nga Parlamenti Hungarez. I kam njoftuar për procedurat e miratimit të buxhetit dhe përfshirë edhe buxhetin e Kuvendit dhe rolin e Komisionit në këtë drejtim. Po ashtu jam njoftuar për procedurat e përgaditjes së buxhetit të Hungarisë dhe Danimarkës, përfshirë edhe buxhetin e institucioneve të pavarura. Si përfundim doli që të hulumtohen praktikatat e vendeve të ndryshme dhe ndoshta ekipi i ekspertëve të ofrojë një raport me informacione për procedurat parlamentare në shqyrtimin e buxhetit apo edhe të organizohet ndonjë takime komisionin dhe të bisedohet për procedurat e buxhetit dhe mënyrën e menaxhimit të institucioneve të pavarura.

5.4. Kryetarja, njoftoi për takimin që ka realizuar me përfaqësues të fondacionit të Westminsterit, ku është biseduar për mundësinë që Kosova të bëhet pjesë e Rrjetit Ballkanik të Komisioneve Ekonomisë dhe Financave të vendeve të rajonit dhe më është dhënë premtimi që edhe Kosova do të bëhet anëtare në këtë mekanizëm dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, do të ftohet të marrë pjesë në takimet e radhës.

5.5. Kryetarja, njoftoi se në bashkëpunim me projektin GIZ, është menduar që Komisioni të realizojë dy vizita studimore në rajon, për të shkëmbyer përvojat dhe për të parë praktikatat parlamentare dhe të funksionimit të komisioneve respektive. Vizita e parë do të realizohet në Shqipëri në muajin qershor, ndërsa vizita tjetër në ndonjë vend tjetër të rajonit dhe në këto vizita do të shkojë komisioni i ndarë në dy grupe. Në Tiranë u vendos të shkojnë: Safete Hadergjona, Naser Osmani, Latif Gashi, Duda Balje, Muhamet Mustafa dhe Xhevdet Neziraj.

Mbledhja përfundoi: 14:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona